



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbim i riparimit të rrethimeve elektrike të kafshëve të egra (felinë)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50000000-5 - Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi;

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,995,116.67 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që

Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri

kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Për arsye se mirëmbajtja është shumë specifike, kërkohej eksperiencë e ngjashme në mirëmbajtje të kësaj natyre, për të siguruar Autoritetin Kontraktor për përmbushjen me sukses të kësaj procedure.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier elektrik/elektronik ose fusha të ngjashme;
- 2 (dy) saldator;

Për punonjësit e mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Diploma për inxhinierin dhe cv;
- b) Certifikata dhe/ose kualifikime për saldatorët;
- c) Kontratë individuale pune e vlefshme për të gjithë punonjësit;
- d) Listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe gërma b, pika 4, neni 41 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtij për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat e shërbimeve, me afatin e zbatimit të realizimit të shërbimit, që është përlogaritur për 1 (një) muaj.

Mirëmbajtja është shërbim riparimesh elektrike dhe punonjësit e mësipërm, me eksperiencën e tyre në realizimin e një shërbimi të tillë të ngjashëm do të mundësojnë realizimin me sukses dhe në kohë të procedurës.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- Çertifikatën e sistemit të menaxhimit mjedisor ISO 14001-2015 ose ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë ISO 45001-2018 ose ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve

publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.3., është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.4. Operatori duhet të deklarojë se do të realizojë çdo mirëmbajtje të nevojshme që mund të krijohet përgjatë 1 (një) viti nga momenti i marrjes në dorëzim të realizimit të shërbimit.

Për shkak të natyrës specifike të shërbimit, kërkohet garancia 1 (një) vjeçare për Autoritetin Kontraktor që çdo riparim i nevojshëm mbi shërbimin e realizuar përgjatë kësaj periudhe do të mbulohet nga operatori.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të përkthyera dhe të noterizuara, nëse janë në gjuhë të huaj.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 77, datë 19.02.2024, me nr. 133 Prot., datë 19.02.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e termave të referencës, si dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës me objekt: “Shërbim i riparimit të rrethimeve elektrike të kafshëve të egra (felinë)”, i cili ka hartuar procesverbalin nr. 133/1 prot., datë 21.02.2024 “Për përcaktimin e termave të referencës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim i riparimit të rrethimeve elektrike të kafshëve të egra (felinë)”. (gjenden në shtojcën 5, 6, 7 në DST).

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me pjesën teknike janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Shërbim i riparimit të rrethimeve elektrike të kafshëve të egra (felinë)”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

Njësia e Prokurimit: